REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës:	2020:036349
Datë:	18.04.2023
Numri i dokumentit:	04196516

APS.nr.50/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – DEPARTAMENTI SPECIAL, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Afërdita Bytyçi– kryetare, Bashkim Hyseni dhe Ferit Osmani – anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli, në lëndën penale ndaj të akuzuarit Z.V, për veprën penale Krimet e luftës kundër popullsisë civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të kryer në bashkëkryerje me pjesëtarët e tjerë të panjohur të njësitit të përmendur rezervist të policisë serbe dhe personat e tjerë të armatosur dhe të uniformuar, duke vendosur në lidhur më ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës si dhe ankesat dhe përgjigjet në ankesë e PS-së të akuzuarit Z.V dhe av.Nebojsa Vlajic, të ushtuara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti Special në Prishtinë PS.nr.28/2022 i datës 11.11.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 15.02.2023, mori këtë:

A K T GJ Y K I M

APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special PS.nr.28/2022 i datës 11.11.2022 vetëm përkitazi me vendimin mbi dënimin, ashtu që kjo

2022:279529

Gjykatë të akuzuarin Z.V, për veprën penale Krimet e luftës kundër popullsisë civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të kryer në bashkëkryerje me pjesëtarët e tjerë të panjohur të njësitit të përmendur rezervist të policisë serbe dhe personat e tjerë të armatosur dhe të uniformuar, i **Cakton Dënim Burgimi** në **kohëzgjatje prej 13 (trembëdhjetë) vite**, në të cilën dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 13 shtator 2022 deri në datën e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e ankesës së Prokurorisë Speciale lidhur me pretendimet për shkelje të ligjit penal kundër aktgjykimit të lartë cituar.

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të akuzuarit Z.V dhe e mbrojtësit të akuzuarit -avokat Nebojsa Vlajic e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentit Special të cituar në pikën I.

A r s y e t i m i

1. Historiku i çështjes

Gjykatës Themelore-Departamenti Special në Prishtinë me aktgjykimin PS.nr.28/2022 i datës 11.11.2022, të akuzuarin Z.V, për veprën penale Krimet e luftës kundër popullsisë civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë e kryer në bashkëkryerje me pjesëtarët e tjerë të panjohur të njësitit të përmendur rezervist të policisë serbe dhe personat e tjerë të armatosur dhe të unformuar, e ka shpallur fajtor dhe e ka gjykuar dënim me burgimi në kohëzgjatje prej 10 vite, të cilin dënim do ta vuan në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Është obliguar i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguajë shpenzimet aq sa do të llogariten sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 100 (njëqind) euro, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

2022:279529

E dëmtuara përmes përfaqësueses së saj për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregull civil.

Të akuzuarit me aktvendim të veçantë PS.28/2022, të datës 11 nëntor 2022 komfor nenit 367 par. 1 pika 1.1 lidhur me par.2, 6 dhe 7 të KPPRK-së, i është vazhduar masa e paraburgimit deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit por jo më shumë se dënimi i shqiptuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, për shkak të vendimit lidhur me sanksion penal dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovoi ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës si të bazuar, ndërsa aktgjykim e ankimuar ta ndryshoj lidhur me sanksionin penal ashtu që të akuzuarit Z.V ti shqiptoj një dënim më të lartë burgimi, ta ndryshoj cilësimin juridik të veprës penale duke e shpallur fajtorë për vepër penale Krimet e luftës kundër popullsisë civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, aktualisht e inkriminiuar si Krimet kundër njerëzimit nga neni 143 par. l nënpar.1.4, 1.6 dhe 1.7 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Përgjigje në ankesën e të akuzuarit Z.V dhe mbrojtësit të tij av.Nebojsha Vlajeviq, ka ushtruar Prokurori Speciale e Republikë së Kosovës, me propozim që ankesa e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij të refuzohen si të pa bazuara, ndërsa ankesa e PS lidhur me vendim mbi dënim të aprovohet si e bazuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit Z.V, av.Nebojsha Vlajeviq, ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve esencialë të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënim dhe për shkak të shkeljes së nenit 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, me propozimin që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoj këtë ankesë si të bazuar dhe aktgjykim e ankimuar ta ndryshoj dhe ndaj të pandehurit Z.V të shpallë aktgjykim lirues për shkak se nuk ka prova se i pandehuri ka kryer vepër penale, ose të prish aktgjykimin e përmendur dhe çështjen ta kthejë në rigjykim.

2022:279529

I akuzuari Z.V, me propozimin që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoi ankesën dhe ndaj të akuzuarit të marrë aktgjykim lirues në mungesë të provave duke potencuar se ndaj tij zhvillohen shume procedura veç e veç dhe pse të njëjtat nuk bashkohen.

Përgjigje në ankesën e PS ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit Z.V, av.Nebojsha Vlajeviq, me propozim qe ankesa e PS të refuzohet si e pa bazuar.

Prokuroria e Apelit me parashtresën: PPA/I.nr.11/23, datë 11.01.2023 ka propozuar që të aprovohet ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikë së Kosovës, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim me i lartë me burgim i cili do të jetë në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, si dhe të ndryshoj kualifikimin juridik të veprës penale krime lufte kundër popullatës civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, aktualisht e inkrimuar si krime kundër njerizimit nga neni 143 par.1 nënpar.1.4,1.6 dhe 1.7 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, kurse ankesa dhe përgjigja në ankese e të akuzuarit dhe mbrojtësit të akuzuarit Z.V, av.Nebojsha Vlajeviq të refuzohen si të pa pabazuara.

Gjykata e Apelit e caktoi dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPK-së në të cilën kanë marrë pjesë, përfaqësuesja e të dëmtuarës D.1 av.Saranda Keqekolla Sadiku, i akuzuari Z.V dhe mbrojtësi i tij me autorizim zëvendësuese Ljubomir Pantoviç, ndërsa nuk kanë prezantuar Prokurori i Apelit dhe mbrojtësi i të akuzuarit av. Nebojsha Vlajeviq, të cilët kanë qenë të njoftuar në mënyrë të rregullt për ditën dhe kohën e mbajtjes së seancës. Gjatë seancës mbrojtësi dhe i akuzuari mbetën pranë ankesave së parashtruara me shkrim nga kolegu i tij, ndërsa i akuzuari mbështeti mbrojtësin e tij.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e kësaj çështje penale, studioi aktgjykimin e ankimuar në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK-së, pas vlerësimit të pretendimet ankimore të Prokurorisë dhe mbrojtjes, konstatoi se:

Ankesa e Prokurorisë Speciale është pjesërisht e bazuar vetëm në raport me sanksionin penal - vendimin për dënim, ndërsa ankesat e mbrojtësit dhe e të akuzuarit janë të pa bazuara.

2022:279529

2. Pretendimet ankimore të Prokurorit të Prokurorisë Speciale

Prokurori i Prokurorisë Speciale në ankesë thekson se gjykata e shkallës së parë më rastin e caktimit të dënimit, nuk i ka vlerësuar drejtë rrethanat që mund të kenë qenë të rëndësishme për shqiptimin e dënimit dhe se po t'i kishte marrë parasysh këto rrethana i akuzuari do të ishte dënuar me një dënim më të rëndë, për arsye se dënimi burgimi prej 10 (dhjet) vite i shqiptuar më aktgjykimin e atakuar nuk është në përputhje me peshën e veprës penale.

Sipas prokurorisë, gjykata e shkallës së parë më të drejtë ka vërtetuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, gjithashtu me të drejtë ka vërtetuar se i akuzuari veprën penale e ka kryer si rezervist i policisë serbe, gjatë luftës në Kosovë dhe se me vetëdije të plotë dhe se me dashje ka dhunuar një grua civile të nacionalitetit shqiptar, mirëpo, gjatë shqiptimit të dënimit gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar në masë të mjaftueshme të gjitha rrethanat e rastit, të cilat do të ndikonin në shqiptimin e dënimit më të rëndë, nuk ka vlerësuar në masë të duhur rrethanën se dhunimi është kryer në mënyrë tejet poshtëruese dhe brutale.

Në rastin kritik, viktima ishte ndarë më forcë nga fëmija e saj të cilën e mbante në krahë dhe me forcë e larguan në një dhomë ku ishin prezentë edhe disa gra të tjera të dhunuara nga policë të tjerë, ndërsa e dëmtuara ishte e dhunuar nga i akuzuari V. për deri sa një person tjetër e abuzonte trupin e saj duke ia mbyllur gojën dhe duke e kafshuar pjesët të trupit. Veprime të tilla dëshmojnë se dhunimin e kishte kryer në mënyrë jashtëzakonisht të egër dhe të vrazhdë, si pasojë e kësaj e dëmtuara ka pësuar dhimbje dhe vuajtje të mëdha fizike dhe psikike, në kohën e dhunimit ajo ishte shtatzëne dhe si pasoj të dhunimit ajo më vonë abortoj foshnjat binjak.

Rrethanat në të cilat është kryer dhunimi dëshmojnë se dhunimi i të dëmtuarës D.I. nuk ka ndodhur si incident i izoluar, ngase gjatë shqyrtimin gjyqësor është vërtetuar se ditën kritike, civilët shqiptarë ishin të rreshtuar në kolonë para një shtëpie tek varrezat e Vushtrrisë ku me atë rast forcat serbe i kishin ndarë femrat të cilat i dhunonin në një dhomë të katit të dytë dhe në mesin e këtyre femrave është dhunuar edhe e dëmtuara D.I, motra e saj, si dhe disa femra të tjera të cilat e dëmtuara D.I i kishte parë me rastin e hyrjes në dhomën e katit të dytë.

Në bazë të dëshmisë së dëmtuarës D.I. e cila ka përshkruar hollësisht torturën dhe tmerrin e përjetuar, si dhe nga dëshmia e dëshmitarëve Dr. H.V dhe Dr. M.I, të cilët në mbrëmjen e ditës kritike kanë kryer ekzaminim e trupit e të dëmtuarës dhe kanë ofruar ndihmë mjekësore, vërtetohet se e dëmtuara në ditën kritike si pasoj e dhunimit ishte në gjendje të vështirë fizike dhe emocionale.

2022:279529

Për gjendjen e rëndë e të dëmtuarës në periudhën e pasluftës kanë dëshmuar mjekja V.D.Xh dhe psikologja S.I.Ç nga QKRMT, të cilat e kanë trajtuar të dëmtuarën në aspektin psiko-social i cili trajtim është në vazhdim e sipër, andaj, në vlerësim të këtyre rrethanave të akuzuarit do të duhej t'i shqiptohet një dënim më i rëndë se ai i shqiptuar me aktgjykimin e shkallës së parë, dhe duhet të vlerësohet fakti se i akuzuari Z.V aktin e dhunimit e ka kryer në kuadër të një sulmi të gjerë dhe sistematik nga forcat ushtarake, policore dhe paramilitare serbe, kundër popullatës civile shqiptare në territorin e komunës së Vushtrrisë dhe kjo është vërtetuar nga dëshmia e të dëmtuarës D.I dhe dëshmitarëve të tjerë të dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor si M.Xh, A.V, M.I, Sh.G, si dhe nga deklarata e dëshmitares D.B.

Përveç dhunimit i akuzuari V., ditën kritike ka rrahur civilët shqiptar, të cilët ishin të detyruar të ulën në tokë dhe me një shkop druri i ka goditur në kokë dhe pjesë të ndryshme të trupit, e pastaj, në bashkëkryerje me personat të tjerë të armatosur dhe uniformuar, i ndajnë meshkujt të rinjtë nga gra dhe fëmijë, i ngarkojnë në kamionë dhe i largojnë nga vendi, për deri sa popullatën e mbetur e rreshtojnë para një shtëpie dykatëshe, kinse për ti pajisur me dokumente identifikimi, me ç 'rast i ndajnë femra të reja dhe i dhunojnë në një dhomë të asaj shtëpie.

Po ashtu sulmi i gjerë dhe sistematik nga forcat ushtarake, policore dhe paramilitare serbe në Vushtrri dhe fshatrat përreth, në kohën e intervenimit të NATO-së në Kosovë, u vërtetua me Aktgjykimin e Tribunalit Penal Ndërkombëtarë për ish Jugosllavin në Hagë (shih Aktgjykimin: Rasti D., nr. IT-05-87/1-T, datë 23 shkurt 2011, Volumi II nga II, Paragrafi 1674, 1676,1677,1678,1679).

Lidhur me shkelje të ligjit penal, Prokurori në ankesë pretendon se me aktgjykimin e atakuar i akuzuari Z.V është shpallur fajtor për vepër penale Krimet e luftës kundër popullsisë civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, i cili ligj ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, meqenëse ky ligj nuk është më në fuqi, gjatë zbatimit të kodit penal konsideron se duhet të verifikohet nëse sjellja kriminale është ende e sanksionuar sipas legjislacionit në fuqi.

Duke u nisur nga fakti se Kreu XVI i Ligjit penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë është titulluar se veprat penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare dhe duke qenë se ky ligj ka inkriminuar shkeljet e rënda e së drejtës ndërkombëtare ndaj popullatës civile gjatë luftës në mesin e të cilëve janë: veprimet çnjerëzore, shkaktimi i vuajtjeve dhe dhimbjeve të mëdha, duke përfshirë edhe dhunimin, rezulton se me këtë ligj ishin të inkriminuara veprimet për të cilat ngarkohet i akuzuari me aktakuzën e prokurorisë.

2022:279529

Prandaj në rastin konkret, vepra penale e kryer nga i akuzuari Z.V duhet të kualifikohet si vepër penale kundër njerëzimit me që në veprimet e tij ekzistojnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale e dënueshme sipas kodit të RSFJ-së dhe KPK-së, sipas dispozitave të dy ligjeve penale, atij që ishte në fuqi në kohën kur kanë ndodh krimet dhe atij aktualisht në fuqi.

Bazuar në këtë gjykata e shkallës së parë ishte e detyruar që pas cilësimit juridik të veprës së kryer penale duke analizuar dispozitat e të dy ligjeve penale të vërtetoj cili nga ato është më i favorshëm për të akuzuarin dhe të shqiptoj dënimin sipas ligjit të më favorshëm, e jo të aplikoj vetëm ligjin nga koha e kryerjes së veprës penale i cili nuk është më në fuqi.

Andaj gjykata me rastin e cilësimit juridik të veprës penale është dashur të aprovoj cilësimin juridik nga aktakuza si vepër penale Krimet e luftës kundër popullsisë civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, aktualisht e inkriminiuar si Krimet kundër njerëzimit nga neni 143 par. l nënpar.1.4, 1.6 dhe 1.7 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Ka shtuar se vepra penale të cilësohet jo vetëm sipas ligjit nga koha në të cilën vepra penale është kryer, por edhe nga aspekti i ligjit që është aktualisht në fuqi, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

3. Pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit Z.V, av. Nebojsa Vlajiq

Mbrojtësi në ankesë thekson se aktgjykim i ankimuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale pasi që gjykata ka qenë jo kompetente vendore dhe përbërja nuk ka qenë në pajtim me ligjin (neni 384. par.1.1 të KPK-së).

Sipas mbrojtjes në bazë të nenit 29 par. 1 të KPPK-së, kompetenca territoriale caktohet sipas territorit ku është kryer vepra, ndërsa vepra për të cilin akuzohet Z.V thuhet se është kryer në Vushtrri andaj është e logjikshme që çështjen ta gjykoj Gjykata në Mitrovicë ku tani më ekziston dhe është duke u zhvilluar procedura për krime lufte kundër të njëjtit të akuzuar.

Ekzistojnë dispozita të veçanta që rregullojnë përbërjen e trupit gjykues në lëndët që vijnë nga komunat me shumicë serbe, siç janë: Marrëveshja e parë e Brukselit nga prilli 2013, në pikën 10, në mënyrë eksplicite dhe plotësisht përcakton se "çdo panel gjyqësor do të përbëhet nga shumica e gjyqtarëve serbë të Kosovës", po ashtu kjo vepër penale, siç thuhet në aktakuzë dhe aktgjykim, është kryer në Vushtrri, e cila nuk ka gjykatën e saj, pra divizionin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, i pandehuri është serb i Kosovës, që përcakton kompetencën ekskluzive të Divizionit të Gjykatës së Apelit në Mitrovicë. Prandaj zhvillimi i kësaj procedure në Prishtinë e jo në Mitrovicë, në

2022:279529

përbërje të kolegjit në të cilin shumica janë Shqiptar, paraqet shkelje të Marrëveshjes së Parë të Brukselit të datës 19.04.2013 dhe neni 3 par 2.5 të Aneksit të Rregullores për organizimin e brendshëm të gjykatave të datës 07.12.2016 dhe kjo për mbrojtjen është e papranueshme.

Lidhur me shkeljet e Nenit 6. të Konventës Evropiane për të drejtave e njeriut, konkretisht nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës i cili përcakton se Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejmë KEDNJ ose Konventa Evropiane) është drejtpërdrejt e zbatueshme në Kosovë dhe ka fuqi më të madhe juridike në krahasim me legjislacionin vendas....., dhe tutje lidhur me këtë i referohet Kushtetutës se Republikës së Kosovës si dhe nenit 6 pat.1 i cili flet për të drejtat për një gjykim të drejtë që përcaktohen sipas Konventës Evropiane.

Si shkeljet tjetër mbrojtja konsideron se dispozitivi i aktakuzës është shkruar në mënyrë jo ligjore, paushalle, arbitrarare dhe pa asnjë provë. Është e paligjshme, e padrejtë dhe e palejueshme që në aktakuzë, të përshkruhen veprimet konkrete të supozuara të pandehurit, prokurori ka shkruar "me qëllim që të kryen dhunim, si pjesë e sulmit të përhapur dhe sistematik ndaj grave të kombësisë shqiptare..." edhe pse për këtë pretendim për një sulm të gjerë dhe sistematik ndaj grave të kombësisë shqiptare nuk ka kurrfarë prove, mirëpo pretendimin e tillë të prokurorit nuk e vërteton me asnjë aktgjykim të asnjë gjykate në Kosovë. Nuk ka asnjë gjykim për përdhunim apo ndonjë dhunë seksuale të kryer gjatë luftës së Kosovë, të pretendosh se është "e përhapur dhe sistematike" është keqdashëse, sepse e vendos të pandehurin në një pozitë më të vështirë sesa është, unë këtu nuk po pretendoj se nuk ka pasur raste të dhunës seksuale apo dhunës ndaj grave gjatë luftës në Kosovë.

Pjesa e tillë e aktakuzës është ajo në të cilën pretendohet se si pasojë e dhunimit, edhe pse katër muaj pas ngjarjes, viktima ka pësuar abort dhe ka humbur binjakët e gjinisë mashkullore, ndërsa ky pretendim ka gjetur vendin e saj në dispozitivin e aktgjykimit, mirëpo këtu përsëri nuk kemi asnjë provë që të ketë ndonjë lidhje me ngjarjen e mëparshme, pasi që gjatë gjykimit nuk është bërë asnjë ekspertizë mjekësore, dhe as një nga mjekët që kemi dëgjuar nuk e ka thënë këtë.

Gjithashtu mbrojtja e konsideron si të palejueshëm zhvillimi e më shumë procedurave për krimeve luftës kundër të pandehurit V., duke shtuar se ndaj të njëjti janë duke u zhvilluar të paktën katër procedura për krime lufte.

2022:279529

Lidhur me shkeljet e ligji penal, ka theksuar se propozimi i provave në seancën kryesore, e jo në aktakuzë është e palejuar dhe është dashtë të refuzohet, por gjykata për të disa herë ka qëndruar në anën e saj, dhe ka lejuar propozimin e provave kur nuk është e lejuar, ka shtuar se në rigjykim ka pritur që prokuroria do ta korrigjonte dhe ta plotësonte aktakuzën me propozim të provave të cilat dëshiron që të administrohen, e që në aktakuzën e parë nuk i ka cekë, mirëpo nuk ka propozuar asnjë provë por gjykata megjithatë i ka administruar provat e propozuara në mënyrë të kundërligjshme nga prokuroria atëherë dhe këtë e përsëritur edhe në rigjykim, në fund të shqyrtimit kryesor ka propozuar administrimin e provave.

Po ashtu duke i'u referuar dispozitave ligjore mbrojtja ka theksuar se rregullat e përgjithshme për administrimin e provave janë paraparë në kapiturin XVI të KPPK dhe përcaktojnë që provat e marra në kundërshtim me KPPK nuk janë të pranueshme (257.2), dhe gjykata nuk e mund ta bazon vendimin e saj në provat e papranueshme (257.3). Në nenin 260.2 thuhet se trupi gjykues mund t'i shqyrtojë provat e pranueshme vetëm nëse ato nuk janë të përjashtuara sipas nenit 249 të KPPK-së, gjegjësisht ato që janë propozuar me kohë dhe kanë kaluar në procedurën e parashtrimit të kundërshtimeve dhe vendosjes për to. Sa i përket shqyrtimit kryesor aplikohet neni 288 KPPK-së i cili ka të bëjë me kërkesat pas seancës së caktuar kryesore. Këtu është situata e qartë. Në bazë të paragrafit 2 provat e reja ose dëshmitarët mund të propozohen vetëm nëse nuk kanë qenë të njohur në kohën e seancës së dytë dhe nëse e drejta e të pandehurit për gjykim të drejtë do të cenohej duke refuzuar kërkesën. [1]

Lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike thekson se mungesën e provave pasi që në këtë çështje kemi të dëmtuarën D 1, e cila thotë se është e dhunuar nga këtu i akuzuari, mirëpo nuk kemi dëshmitarë që e vërteton tregimin e saj, pasi që prokuroria nuk ka siguruar asnjë provë, as edhe një dëshmitar të pranishëm në atë vend në shtëpinë e M.Gj në Vushtrri, po ashtu edhe e dëmtuara thotë se nuk ka qenë vetëm dhe se sipas fjalëve të saj me të kanë qenë "babai, nëna, gjashtë motra, vëllai vjehrra..." dhe askush prej këtyre personave (natyrisht nuk janë sot të gjithë gjallë) prokuroria nuk i ka ftuar të dëshmojnë. Po ashtu dy mjekë të cilëve thuhet se e dëmtuara i'u është drejtua për ndihmë mjekësore, ata nuk janë dëshmitarë të ngjarjes, por përveç gjendjes së përgjithshme të pacientes, A.V, mjeku që e ka pranuar, thotë se nuk e ka ekzaminuar gjinekologjikisht pacienten, por ka thirrur mjekun që e ka ekzaminuar, kurse në pyetjen nëse ka qenë prezent në momentin e kur e ka kontrolluar Dr. M, ky dëshmitar ka thënë se nuk ka qenë " ai është larguar", ndërsa dëshmitarja doktoresha M. thotë "më ka thirr doktor A.,

[1] Ankesa e paraqitur nga mbrojtësi i të akuzuarit – avokat Nebojsha Vlajiq.

2022:279529

më ka thënë ka një rast, a po vini, është femër...". E pyetur nëse e ka ekzaminuar pacienten, dëshmitarja thotë "Unë nuk jam gjinekologe, kam bërë kontroll fizike... e kam shikuar me sy", dhe nga kjo rrjedh se ky ekzaminim nuk ka qenë gjinekologjik.

Ndërsa sa i përket identifikimit të akuzuarit, dokumentimi lidhur me atë nuk ka kurrfarë rëndësie, pasi që nga 10 marsi 2016, kur u arrestua Z.V e deri më sot, shtypi dhe mediat e Kosovës kanë shkruar për të dhe procedurën penale në vazhdim në mënyrë shumë të njëanshme dhe të paligjshme dhe kanë publikuar fotot e tij dhe atë të njëjtat që i ka policia dhe prokurori publik dhe të cilat më pas iu treguan dëshmitarëve për qëllime identifikimi. Tutje i është referuar teksteve të publikuara, se më datën 11.03.2016, një ditë pas arrestimit të V., më datën 12.11.2016 kur u ekstradua në Kosovë dhe kur i është caktuar paraburgimi, dhe më datën 20.04.2017 kur është ngritur akuza, mbi këtë bazë është e qartë se është e pamundur të mos njohësh dikë, fotografitë e të cilit shtypi në Kosovë i publikon çdo ditë, që nga arrestimi i tij në mars të vitit 2016 e deri më sot, dhe po ashtu është e qartë se është e pamundur të mos njohësh dikë që thua se njihen që nga më parë.

Në bazë të nenit 361.1 të KPPK-së gjykata e bazon aktgjykimin në provat dhe faktet e vërtetuara në shqyrtim kryesor. Për arsye të kuptueshme, edhe para fillimit të gjykimit, gjykata vendosi që të fsheh identitetin e viktimës dhe i dha asaj pseudonimin D 1. Gjithashtu, dëshmitarët e dëgjuar nga gjykata u njoftuan që të mos thonë apo përdorin emrin e viktimës, që ata e respektuan. Në dëshmitë e tyre kanë përdorur shprehjet "paciente, një grua, ajo grua, ajo." Doktoresha M. as nuk e njihte, as nuk e pyeti për emrin. Pra, tani nuk e dimë se për cilin person kanë dëshmuar, për të dëmtuarin D 1, ndoshta për motrën e saj S. (të cilën gjithashtu e kanë kontrolluar) ose rreth një personi të tretë femër. Ndërsa lidhur me vendim mbi dënim, ka theksuar se për peshën e dënimit nuk mund të diskutohet sepse konsideron se procedura e zhvilluar është e paligjshme, më një gjykatë pa kompetencë territoriale dhe lëndore territoriale, me mungesën e kushteve të ekstradimit për gjykim, sepse dokumentet lidhur me të janë paraqitur në ditën e fundit të gjykimit.

4. <u>Pretendimet e të akuzuarit Z.V</u>

I akuzuari në ankese thekson se edhe në rigjykim përsëri është dënuar me 10 (dhjete) vjet burg për kinse krime lufte dhe se është gjykuar nga trupi gjykues me përbërje të njëjtë si në shqyrtimin paraprak, aktakuza ka mbetur e njëjtë pa ndryshime, pa dëshmitarë të rinj dhe pa prova të reja,

2022:279529

dhe aktgjykimi ka qenë i njëjtë me atë të mëparshmin, kurse pyetjet të cilat prokurori i bëri dëshmitarit të mbrojtur D1 ishin të njëjta si në gjykimin e kaluar, po ashtu as në rigjykimi nuk u sqarua asgjë e re, përkundër rekomandimeve të Gjykatës se Apelit.

Duke theksuar se në procedurë është shënuar një detaj i ri, në pyetjen e tij si ka arritur të më identifikoj kur për herë të par ka hyrë në gjykatore, edhe pse .....D1 është përgjigjur se e ka identifikuar, sepse maska mbrojtëse e ka mbuluar vetëm gojën, mirëpo kjo është gënjeshtër.

Lidhur me deklarimet e dëshmitarëve i akuzuari thekson se; Dëshmitarja D1 në deklaratën para gjykatës thotë se për herë të parë ka dëgjuar për emrin e tij dhe mbiemrin derisa ka pritur në radhë para lokalit për regjistrimin e popullsisë shqiptare (do të thotë para dhunimit të supozuar), derisa në deklaratën e dytë të dhënë në prokurori, D1 thotë se për mbiemrin V. ka kuptuar nga mjeku V pas asaj ngjarje. Ndërsa sa i përket përshkrimit të pamjes fizike, D1 në deklaratën e parë të vitit 2018 cekë se "Z." është i gjatë rreth dy metra, flokë të zeza" derisa në deklaratën para gjykatës thotë se "Z." është i gjatë, ngjyrë të kaftë të flokëve". Kjo është ndryshe në raport me deklaratën e mëparshme: e zeza dhe kafe nuk është njëjtë, derisa termi "i gjatë " i papërcaktuar mund të interpretohet në mënyra të ndryshme. Dëshmitarja D1 në pyetjen e trupit gjykues a është kontrolluar gjinekologjikisht, u përgjigj pozitivisht dhe u kap në gënjeshtër! Pasi që personat të cilët e kanë kontrolluar, Dr.V dhe Dr.I, në deklaratat e tyre kanë thënë se e kanë kontrolluar vetëm sipërfaqësisht (me sy), dhe se nuk kanë bërë kontroll gjinekologjike, e që është e logjikshme sepse të dy kanë qenë mjek të praktikës së përgjithshme në atë kohë, sipas fjalëve të tyre. D1 në deklaratën pranë gjykatës në pyetjen e avokatit, sa ka qenë e madhe dhoma në të cilën kanë qenë gratë e zhveshura, është përgjigjur 4 me 4m. Sipas saj në dhomën 16 metra katrorë rezulton se kanë qenë 19 persona (13 polic dhe 6 femra, këto janë fjalët e D1) dhe plus aty kishte disa kolltukë, bazuar në këtë është thjesht e pabesueshme që të gjithë i nxinte brenda.

D.B (nëna e D1), kjo dëshmitare (e cila nuk është sjellë në gjykatë) me asnjë fjalë të vetme nuk përmend kurrfarë emra të personave të uniformuar, as nuk është në gjendje që në çfarëdo mënyre ti përshkruaj.

A.V (mjek), ky dëshmitar, sipas fjalëve të tij gjatë kohës së bombardimeve ka punuar si mjek i praktikës së përgjithshme në Vushtrri, i njëjti në pyetjen e prokurorit a ka pasur ordinancë private, është përgjigjur negativisht (deklarata e vitit 2021), derisa në deklaratën e vitit 2018 ka thënë se ka punuar " në ambulanten e tij të improvizuar ", kështu që është e paqartë se çfarë lloj mjeku

2022:279529

ishte ai në radhë të parë, a ka qenë fare mjek në atë kohë. Doktori i lartpërmendur nuk mbante fare evidencë të pacientëve, ai vetëm thotë në të tri deklaratat se asnjë pacient, përfshirë edhe D1, nuk e ka shënuar në regjistër – protokoll për pranin dhe kontrollin e pacientëve, që është jashtë mendjes! Kurse tuje i referohet paqartësive dhe kundërthënieve në deklaratat e Dr.V., me rastin e gjoja pranimit të pacientes D1, mjeku V. në deklaratën para gjykatës thotë se D1 ka qenë "në gjendje kome". Në pyetjen e gjykatësit çka nënkupton në atë gjendje, mjeku V. është përgjigjur "Shpirtërisht e lodhur". Në vazhdim të përgjigjes Dr. V thotë "shpirtërisht e lodhur", dhe në një moment asaj iu kujtua një emër, të cilin person e kam njohur.." Mjeku thotë se ajo e tha këtë në koma, kështu që është thjesht e pabesueshme! Në pyetjen e prokurorit para gjykatës a ka qenë i pranishëm kur pacienten D1 e ka kontrolluar mjekja M., Dr.V është përgjigjur "jam larguar", por në deklaratën e vitit 2020 ai thotë, "kam qenë gjatë gjithë kohës i pranishëm dhe M. gjatë gjithë kohës ka komunikuar me mua" Në deklaratën e tij të parë të vitit 2018 Dr.V thotë "si e kam parë e kam ditë se është viktimë e dhunës seksuale" (mendohet në D1). Nuk e di si mund ta thotë këtë një mjek, e pa pasur para vetes rezultatet e një kontrolli gjinekologjik. Në pyetjen e policisë në vitin 2018 "a e keni pyetur ju pacienten kush e ka dhunuar", Dr.V thotë "se direkt nuk e kam pyetur, por ajo vetë tha se Z.V e solli në këtë gjendje" por në deklaratën para prokurorisë të vitit 2020 doktor V thotë "e kam pyetur kush ta ka bërë këtë". Pastaj, në deklaratën e vitit 2020, Dr.V thotë se e ka pyetur pacienten D1 "kush e ka dhunuar, ajo është përgjigjur Z.". Unë e kam pyetur cili Z., ajo është përgjigjur Z.V". Por për atë D1 në deklaratën e vitit 2020 thotë " se mbiemrin e V. e ka kuptuar prej Dr. V." , edhe një tjetër divergjencë në pretendime.

M.I (mjeke) për dallim nga kolegu i saj, Dr.V., kjo dëshmitare cekë më pak detaje me rastin e kontrollimit të D1 ditën kritike Dr. M. fare nuk përmend se D1 ka qenë pa vetëdije, e çorientuar dhe në gjendje kome! Edhe Dr. M. dhe Dr.V., janë pajtuar se pacienten D1 nuk e kanë shënuar në regjistër për pranimin e pacienteve, si dhe atë se nuk është bërë kontrolle gjinekologjike.

Dëshmitari M.Gj ky dëshmitar përmend një ngjarje tjerë për të cilën kinse ka dëgjuar prej personave tjerë. Ai erdhi në gjykatë me pretendimin se unë gjoja isha afër vendit të ngjarjes në datën kritike dhe si hyrje në të gjitha këto ai imagjinon një tregim se kinse unë para asaj kam shkuar nëpër shtëpi duke plaçkitur, ndërsa as këtë nuk e ka parë personalisht! Në pyetje të policisë të vitit 2018, a më ka parë në shtëpi ku është bërë regjistrimi i popullatës shqiptare është përgjigjur negativisht. Po ashtu njëjtë në deklaratën e dhënë në polici, në pyetjen se a ka dëgjuar se pas lufte dikush ka folur për ndonjë dhunim në atë shtëpi njëjtë është përgjigjur negativisht! Ndërsa atë se më ka identifikuar me fotoalbum të policisë nuk është kurrfarë prove. Në atë

2022:279529

mënyrë do të më identifikonte gjysma e qytetarëve të Vushtrrisë, sepse para dhe gjatë luftës kamë punuar në gjykatë me palë, ashtu që shumica më njohin.

Dëshmitari Sh.G (mjek), sipas fjalëve të tij, për herë të parë e ka takuar D1 në vitin 2013.Ai në gjykatë rrëfen çka i ka thënë ajo atij për gjoja dhunimin, por Dr.Sh. nuk është dëshmitar okular i ngjarjeve të cilat janë objekt i aktakuzës, prandaj në mungesë të ndonjë dijenie për këtë, ai i tha policisë në vitin 2018 se kishte dëgjuar nga disa persona të vdekur se gjoja kisha kryer disa dhunime në vende të tjera!?. Dëshmitarët S.Ç dhe V.D, përshkruaj gjendjen psikofizike të D1 prej vitit 2017 e tutje, mirëpo ato nuk janë dëshmitare okularë të ngjarjes.

Ndërsa prokuroria në gjykim nuk ka ftuar askënd nga dëshmitarët e tjerë okularë të supozuar të asaj ngjarje, të cilët mund të konfirmojnë ose jo që e kanë parë D 1 në vendin kritik në ditën kritike, edhe pse sipas vetë D 1, nëntë anëtarë të familjes së saj ishin të pranishëm atje. Prandaj nga kjo rrjedh se nuk e ka dhunuar D1, dhe se i mohoj të gjitha pretendimet e aktakuzës dhe kërkon të merret aktgjykim lirues, gjithashtu cek se vetëm kundër tij zhvillohen disa procedura gjyqësore krim të supozuar lufte, dhe se është i vetmi që ka shumë vendime gjyqësore, qoftë lirues qoftë dënues. Një rast i tillë nuk është regjistruar në praktikën gjyqësore ndërkombëtare. Pse gjykata nuk i bashkon të gjitha procedurat në një, por secila gjykohet veçmas. Për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë

5. <u>Përgjigjet në ankesa</u>

Prokurori i prokurorisë Speciale në përgjigje në ankesë e mbrojtësit tët ë akuzuarit Z.V, avokati Nebojsha Vlajiq, thekson se pretendimet e mbrojtësit lidhur me kompetencë dhe për bashkim të procedurës nuk janë të bazuara dhe se në rastin konkret nuk ka pasur vende për bashkim e procedurës sepse rasti i dhunimit është raportuar dhe është zhvilluar procedurë penale në kohën kur rastet tjera kundër të akuzuarit ishin në rigjykim, pra rasti i dhunimit është hetuar në mënyrë të pavarur nga rastet e tjera ku pas ngritjes se aktakuzës rasti i ri është dërguar në Departament Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë i cili është kompetent për gjykim të rasteve për krime lufte, ndërsa Gjykata Themelore në Mitrovicë e ka mbajtur kompetencën për rastet në rigjykim.

Është e paqëndrueshëm ankesa e mbrojtësit të akuzuarit përkitazi me përkatësin etnike të trupit gjykues, i cili ka vendosur në shkallë të parë duke ditur se Departament Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë për momentin nuk ka asnjë gjyqtar të nacionalitetit serb, ndërsa si i

2022:279529

akuzuari edhe mbrojtësi qysh në fillim të procedurës janë pyetur nëse kanë vërejtje në përbërjen e trupit gjykues, kurse përgjigja ka qen se nuk kanë vërejtje.

Ndërsa lidhur me pohim e mbrojtësit se nuk ka prova për qëllimin e të akuzuarit për dhunim si pjesë e sulmit të gjerë dhe sistematik ndaj grave të etnisë shqiptare, ky pretendim nuk është i bazuar pasi që gjatë shqyrtimit gjyqësor në mënyrë të pa kontestueshme është vërtetuar se në qytetin e Vushtrrisë dhe rrethin e tij si dhe mbarë Kosovën ka pasur dhe është zhvilluar një sulm i gjerë dhe sistematik nga forcat ushtarake, paramilitare dhe policore serbe kundër popullatës civile dhe se e dëmtuara ishte pjesë e dhunimit të tij sulmi ku ishin dhunuar edhe shumë femra të tjera.

Përfundimisht, nuk qëndrojnë pretendimet e mbrojtjes se në rastin konkret nuk ka asnjë provë që e dëmtuara ka qenë në vendin e ngjarjes, dhe nuk ka asnjë dëshmi se e njëjta ishte dhunuar, ky është një pretendim irionik, pasi që përveç të dëmtuarës të gjithë dëshmitarët qysh në faza hetimore kanë dëshmuar për rastin konkret , e kanë dhënë emrin e të dëmtuarës dhe po ashtu këta dëshmitare kanë dhënë dëshmi identike dhe në shqyrtimin gjyqësor. Gjithashtu e dëmtuara D1 në mënyrë të sigurt qysh në hetuesi e ka identifikuar kryerësin mizor të kësaj vepre penale, ndërsa gjatë shqyrtimit gjyqësor e njëjta i është drejtuar duke kërkuar nga ai që ta shikoj në sy dhe duke i thënë se ti je ai që e ka dhunuar, dhe i'a ka shkatërruar jetën, për arsyes të lartcekura ka propozuar si me lartë.

Mbrojtësi i të akuzuarit Z.V, av.Nebojsha Vlajiq, në përgjigje në ankesën e prokurorit Special të Kosovës ka theksuar se për peshën e dënimit nuk mund të diskutohet sepse konsideroj se një procedurë e zhvilluar është e paligjshme, me një gjykatë pa kompetencë territoriale dhe lëndore, me mungesën e kushteve të ekstradimit për gjykim sepse dokumentet lidhur me të janë paraqitur në ditën e fundit të gjykimit, me provat e paraqitura nga ana e prokurorit publik në seancën e fundit (dhe jo në aktakuzë ku është dashur të bëhet) kur kanë kaluar të gjitha afatet për këtë dhe arsyetimi i prokurores ka qenë se është gabim teknik, me një shembull të paprecedentë në historinë e drejtësisë zhvillimi i më shumë procedurave kundër një personi për veprën penale të krimeve të luftës dhe me një aktgjykim të nxjerr pa kurrfarë prove lidhur me ngjarjen, të qojnë deri të aktgjykimi i paligjshëm Sipas mbrojtës në këtë procedurë çdo dënim është i paligjshëm, absurd dhe rigoroz, ndërsa ankesa e prokurorit publik në tërësi është e pabazuar. Në ankesën e prokurorit publik përsëritet pretendimi i pavërtetuar që përmendet në aktakuzë, i cili shërben vetëm për vënien në pozitë më të vështirë të akuzuarit. Pretendimi se si pasojë e dhunimit edhe

2022:279529

katër muaj pas ngjarjes, viktima ka pësuar një abort dhe ka humbur binjakët meshkuj, nuk ka asnjë provë që të ketë lidhje me ngjarjen e mëparshme. Gjatë gjykimit nuk është bërë asnjë ekspertizë mjekësore dhe as një nga mjekët që kemi dëgjuar nuk e ka thënë këtë, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

6. Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

6.1.Të gjeturat lidhur me pretendimet për shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e lartë cekura ankimore nuk qëndrojnë e as që ka shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale, për të cilat, sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar. Në këtë aspekt janë të pabaza pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parapara nga neni 384 të KPP-së, ngase, dispozitivi i aktgjykimi është i qartë, i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e aktgjykimit janë dhënë arsyet e duhura mbi faktet vendimtare të kësaj çështje penale-juridike.

Për rrjedhojë, gjykata e shkallës se parë ka bërë analizën e të gjitha provave të procedura gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive, dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë.

Është i pabazuar pretendimi ankimor i mbrojtësit të akuzuarit për kompetencën e gjykatës dhe përbërjen e saj, se e njëjta nuk ka qenë në pajtim me ligjin pasi që vepra për të cilin akuzohet Z.V është kryer në Vushtrri, duke iu referuar edhe Marrëveshjes së Brukselit në fushën e drejtësisë Kosovë- Serbi, andaj çështjen është dashur që ta gjykoj Gjykata në Mitrovicë.

Kolegji vëren se sipas Ligjit për Gjykata Nr. 06/L - 054 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 22 / 18 Dhjetor 2018, Prishtinë): neni 13. 1.1.:

“ Në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, vepron Departamenti Special për Lëndët në Kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, me kompetencë për tërë territorin e Republikës së Kosovës:

Dispozita e cituar përcakton se Gjykata Themelore-Departamenti Special në Prishtinë është kompetent për lëndët në kompetencën e Prokurorisë Special të Republikës së Kosovës, për faktin

2022:279529

se ky departament ka juridiksion për tërë territorin e Republikës së Kosovës, dhe se vepra penale e cila është objekt i akuzës bie në kuadër të këtij juridiksioni.

Rregullorja e Këshillit Gjyqësor të Kosovës evidentuar 03/2019 për Organizimin dhe Funksionalizimin e Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe Gjykatës së Apelit, neni 3 përcakton:

”Departamenti Special në kuadër të Gjykatë së Apelit gjykon në kolegj prej tre gjyqtarëve profesionist në shkallë të dytë dhe ka kompetencë që të shqyrtoj lëndët sipas paragrafit 1 të këtij neni me juridiksion territorial për gjithë territorin e Kosovës”.

Në këtë kontekst juridiksioni i Departamentit Special i Gjykatës së Apelit mbulon tërë territorin e Republikës së Kosovës si shkallë e dytë, për të gjitha ankesat ndaj vendimeve të Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë për lëndët sipas aktakuzave të Prokurorisë Speciale.

Pretendimi për përkatësinë etnike të trupit gjykues i cili ka vendosur në shkallë të parë, është pretendimi i paqëndrueshëm duke e dituar faktin se Departamenti Special i Gjykata Themelore në Prishtinë, për momentin nuk ka gjyqtar të përkatësisë etnike serbe.

Kolegji vlerësoi pretendimet e mbrojtësit se “dispozitivi i aktakuzës është shkruar në mënyrë jo ligjore, arbitrare dhe pa asnjë provë... dhe se është e padrejtë që në aktakuzë, të përshkruhen veprimet konkrete të supozuara të pandehurit, se i njëjti “me qëllim që të kryen dhunim, si pjesë e sulmit të përhapur dhe sistematik ndaj grave të kombësisë shqiptare... edhe pse pretendimin e tillë nuk e vërteton me asnjë aktgjykim të asnjë gjykate në Kosovë”, si të pabazuara, për më tepër të ekzagjeruara e jashtë kornizës së përshkrimit të fakteve në aktakuzë dhe në dispozitiv të aktgjykimit, për faktin se nga përshkrimi i veprimeve inkriminuese në dispozitiv rezulton si më poshtë :

“I akuzuari Z.V, si pjesëtar i forcave policore të njësisë rezervë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, në bashkëkryerje me pjesëtarët e tjerë të këtij njësiti, mori pjesë në kryerjen e dhunës fizike dhe psikike ndaj popullatës civile shqiptare, ku me përdorimin e dhunës dhe veprimeve të tjera çnjerëzore, në kundërshtim me rregullat e të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare, në muajin maj të viti 1999 gjatë luftës në Kosovë ka kryer dhunim seksual ndaj gruas së nacionalitetit shqiptar, në territorin e Komunës së Vushtrrisë …”

Rrjedhimisht, objekt trajtimi është vepra penale që rezulton e kryer me datën 22 maj 1999 në kontekst të rrethanave të konfliktit të armatosur, nga faktet e çështjes konstatohet se i akuzuari po vepronte si pjesëtar rezervë i formacioneve policore MPB-të Republikës së Serbisë, të cilët ishin përfshirë kryerjen akteve të dhunshme fizike dhe psikike ndaj popullsisë civile shqiptare

2022:279529

në kundërshtim me rregullat e së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare, dhe gjatë kësaj kohe kishte kryer dhunimin ndaj gruas të nacionalitetit shqiptar, dhe kjo nuk ndërlidhet me faktin se a ka ndonjë aktgjykim për dhunë seksuale për ndonjë rast tjetër.

Në rastin konkret, vërtetohet se i akuzuari me veprimet e tij inkriminuese në bashkëkryerje me pjesëtarët e tjerë të panjohur të njësitit të përmendur rezervist të policisë serbe dhe personat e tjerë të armatosur dhe të uniformuar, ishin përfshirë në deportimin, kryerjen akteve të dhunshme fizike dhe psikike të popullsisë civile shqiptare, dhe në raport me tani të dëmtuarën D1 kryen dhunim seksual, si rezultat i së cilës konsumuan tiparet e veprës penale krimet e luftës kundër popullsisë civile të sanksionuara nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, andaj konkludimi gjykatës së shkallë së parë me të drejtë është mbështetur në provat dhe dëshmitë që inkriminojnë veprimet e të akuzuarit.

Pretendimet e mbrojtësit se gjykata ka shkelur dispozita procedurale të cituara në ankesë për arsye se propozimi i provave në seancën shqyrtimit kryesor, e jo në aktakuzë është e palejuar dhe është dashtë të refuzohet, por ka lejuar propozimin që të administrohen si prova që në aktakuzë nuk i ka përmend, përderisa mund të propozohen vetëm prova të reja që deri më atëherë nuk ishin të ditura.

Kolegji ndan të njëjtën pikëpamje si gjykata e shkallës së parë për këtë pretendim, dhe vëren se në aktgjykimin e ankimuar jepen arsye të mjaftueshme dhe bindëse, se provat e propozuara nga prokuroria në seancën e shqyrtimit gjyqësor, sikurse për gjykatën e shkallës së parë, po ashtu edhe për mbrojtjen dhe të akuzuarin si dhe përfaqësuesen e palës së dëmtuar nuk ishin prova të reja, ishin prova të cilat i janë vënë në dispozicion mbrojtësit, të akuzuarit dhe të gjitha palëve dhe është bërë zbulimi i tyre me kohë, ngase të gjitha palët ishin të pajisura me të gjitha ato shkresat të lëndës dhe nuk kishte asnjë provë të re, përveç shkresës nga Komisioni Qeveritar e cila ka të bëjë se dëmtuara D.1 ka fituar statusin e të dhunuarës.

Kurse të gjitha provat e tjera palët kanë qenë në dijeni, ishin pjesë e shkresave të lëndës, prandaj një gabim teknik i bërë nga ana e prokurorisë nuk mund të shërbej si pretekst që këto prova të shpallen të papranueshme, për arsye se nuk ishin prova të reja por ishin ato që i kishin të gjitha palët dhe ishin të zbuluara me kohë dhe se me administrimin e këtyre provave në asnjë mënyrë nuk është vështirësuar apo rënduar gjendja e të akuzuarit sipas pretendimit të mbrojtjes, ngase pikërisht mbi bazën e të njëjtave është ngritur aktakuza.

2022:279529

Kolegji njëkohësisht vlerëson se është e përgjithësuar pjesa ankimore se është cenuar e drejta për gjykimin e drejtë nga neni 6 i KEDNJ-së dhe neni 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nuk shpjegohet qartësisht, as nuk konkretizohet më detajisht se në çka konsistojnë cenimet e këtyre dispozitave, se cila shkelje specifike të dispozitave konstatohen se janë shkelur dhe e kishin peshën e tillë sa i akuzuari të mos kishte një proces të rregullt dhe të drejtë gjyqësor, nëse i referohet shkeljeve të pretenduara më sipër në raport me propozimin e provave në shqyrtimin gjyqësor, tani më janë dhënë shpjegime në paragrafin më lart, dhe kjo pjesë e ankesës është trajtuar si e pabazë.

6.2. Të gjeturat për pretendimet ankimore për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike

Në raport me pretendimet ankimore për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit e Kosovës konstaton se gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Nga provat e prezantuara gjatë shqyrtimit gjyqësor derivon e provuar se i akuzuari Z.V, në mënyrën e përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, si pjesëtar i forcave policore të njësisë rezervë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, në bashkëkryerje me pjesëtarët e tjerë të këtij njësiti, mori pjesë në kryerjen e dhunës fizike dhe psikike ndaj popullatës civile shqiptare.

Me datën 22 maj të vitit 1999, tek varreza e Vushtrrisë, forcat ushtarake, policore dhe paramilitare serbe në mesin e të cilëve edhe i akuzuari Z.V, tubuan popullatën civile shqiptare që më parë ishin dëbuar nga vendbanimet e tyre i urdhëruan të ulen të tokë dhe për derisa ishin në atë pozitë, i akuzuari me një mjet- shkop të drurit fillon ti rrahë duke i goditur në kokë dhe pjesë të ndryshme të trupit dhe në bashkëkryerje me pjesëtarët e tjerë të njësitit të përmendur i ndajnë meshkujt e rinj, i ngarkojnë me kamionë dhe i largojnë nga vendi në drejtim të panjohur.

Ndërsa gratë, fëmijët dhe pleqtë i detyrojnë të presin në kolonë para një shtëpie dykatëshe, kinse për ti pajisur me kartela të identifikimit dhe me të ardhur rendi tek e dëmtuara D.1 i akuzuari e mori me forcë duke e futur në një dhomë në katin e dytë të asaj shtëpie ku kishte edhe femra të tjera të zhveshura të cilat dhunoheshin nga policët, ku në prezencën e atyre femrave dhe policëve të tjerë i akuzuari përplasi të dëmtuarën për dysheme, me forcë ia shqyen rrobat dhe kryen aktin

2022:279529

seksual - dhunimin së bashku edhe me një policë tjetër deri tani i paidentifikuar, i cili përderisa i akuzuari Z. e dhunonte, polici tjetër i paidentifikuar ia mbyllte gojën, e kafshonte dhe ia shtrëngonte gjokset.
Në momentin kur e dëmtuara nga dhimbjet kthehet me trup anash, i akuzuari Z. e godet me shqelm në pjesën e kurrizit nga e cila goditje kishte humbur vetëdijen, ku e dëmtuara në kohën e dhunimit ishte shtatzëne në muajin e tretë, kurse në shtator të po atij viti kishte pësuar abort ku ka humbur dy foshnje binjake të gjinisë mashkullore dhe pëson trauma të rënda fizike dhe psikike.

Deri të kjo gjendje faktike, gjykata e shkallës së parë kishte ardhur pas administrimit provave në shqyrtimin gjyqësor siç janë: dëshmia e dëshmitares D.1 dhe dëshmitarët A.V, M.I, Sh.G, M.Xh, S.I-C dhe V.D-Xh, kurse është lexuar dhe administruar edhe dëshmia e dëshmitares D.B, si dhe provat materiale që janë: Procesverbalin mbi identifikim e personit përmes fotografisë nga dëshmitarja D.1 të datës 03.04.2018, raportet mjekësore të dëmtuarës dëshmitare D.1, Procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitares D.B e datës 30.03 2018, Procesverbali mbi identifikimin e personit përmes fotografisë nga dëshmitari M.Xh, i datës 17.07.2018, Fotoalbumi nga vendi i ngjarjes dhe skicimi i vendit të ngjarjes të datës 24.04.2018, shkresat për dhënien e pëlqimit për ndjekje penale datë 08.11.2018, shkresa e Malit të Zi datë 09.03.2019, kërkesa e PSRK-së për dhënien e pëlqimit për ndjekje penale datë 07.08.2019, Urgjencë e PSRK për dhënien e pëlqimit për ndjekje penale datë 25.09.2019, shkresa e MD me numër 04/2-2473-K/16 e datës 24.10.2019 si dhe shkresa me të cilën Komisioni Qeveritar për njohjen dhe Verifikimin e Statusit të personave të dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës, të dëmtuarës, dëshmitare D.1 i është njohur statusi me datë 24.08.2018.

Kolegji i Apelit vëren se thelbi i çështjes faktike është nëse i akuzuari është identifikuar në mënyrë të sigurt nga e dëmtuara D1, dhe a konfirmonin mjaftueshëm dëshmitë e tjera mbështetëse këtë rrethanë, pra duhet të vlerësohet efekti plotësues i këtyre dëshmive.

Në këtë drejtim është e nevojshme të shqyrtohet tërësia e krejt dëshmive për këtë çështje, duke i marrë në konsideratë faktorët e rëndësishëm që ndikojnë në identifikim, siç janë: mundësia e dëshmitares për të parë të akuzuarin në kohën e kryerjes së veprës penale, shkallën e vëmendjes me rastin e përceptimit, saktësia e përshkrimit paraprak që i bën dëshmitarja të akuzuarit, niveli i sigurisë së demonstruar gjatë dëshmisë dhe shqyrtimit gjyqësor, koha e kaluar ndërmjet veprës penale dhe identifikimit[2], andaj, në tërësinë e këtyre faktorëve dhe dëshmive plotësuese duhet të

[2] Neil v. Biggers - 409 U.S. 188, 93 S. Ct. 375 (1972).

[3] An article by Ann Maass and Gautier Kohnken, in the Law and Human Behaviour Journal, voL 13, no. 4, 1989, was shown to the witness and discussed in cross-examination . Trans., 2 Jul. 1998, p. 10).

2022:279529

përcaktohet nëse është arritur që identifikimi të jetë i besueshëm, dhe i saktë nga pikëpamja objektive.

Ngjarjet për të cilat dëshmoi e dëmtuara janë të natyrës traumatike, ekzistojnë pikëpamje të ndryshme lidhur me kategorinë e këtyre dëshmitarëve për të dëshmuar për këto rrethana, prej atyre të cilat konsiderojnë se ngjarjet e tilla mund të ndikojnë tek dëshmitarët që të dëshmojnë me kujtime veçanërisht të gjalla dhe të detajuara[3], e deri tek ato që shprehin rezerva lidhur me besueshmërinë e tyre.

Nga pikëpamja njerëzore e psikologjike ngjarjet e tilla mbesin në kujtesë për kohë të gjatë, madje mund të mbesin edhe përjetësisht në varësi të intensitetit për dallim nga ndodhitë e zakonshme të cilat humbin dhe zbehen nga kujtesa për një kohë dukshëm më të shpejt.

Në jurisprudencën e Tribunaleve Penale Ndërkombëtare është praktikë e pranuar se dëshmitë e tilla, nuk mund të shpërfillen vetëm pse ato përshkruajnë realitete traumatike dhe të tmerrshme, por çdo mospërputhje dhe pasaktësi në dëshmi nevojitet të shqyrtohen me kujdes e në dritën e rrethanave me të cilat u përball dëshmitari/a.[4]

Në rrethanat e çështjes, rrjedh se e dëmtuara D1 në dëshminë dhënë gjatë procedurës hetimore në polici, më pas në prokurori, e në shqyrtim gjyqësor ishte konsistente në përshkrimin e ngjarjes së ditës kritike, fakteve dhe rrethanave thelbësore të cilat dërguan deri tek identifikimi i të akuzuarit, e cila deklaroi se emrin Z.V, e kishte dëgjuar fillimisht në turmën e njerëzve, të cilën e përshkruan si brutal dhe të rrezikshëm.

Në dëshminë e dhënë në hetuesi- si në vijim:

"Deri sa prisja në radhë kam vërejtur se njëri nga personat e uniformuar që ishte brenda me shikonte mua rregullisht, unë e pash menjëherë mu kujtua që ketë person e kam parë edhe në fshatin Studime me dt.2 maj 1999 deri sa shkonim në kolonë dhe në Kooperativë Bujqësore.....disa pleqë të moshuar pëshpëritin dhe thoshin mes vete "se këtu brenda koka edhe Z.V".

E dëmtuara në dëshminë e dhënë në Prokurori kishte deklaruar:

"Duke pritur në rresht unë kam dëgjuar qysh disa pleq kanë thënë se aty qenka Z. dhe se ky është njëri i keq dhe i rrezikshëm..... Unë isha afër vjehrrës sime kur mu ofrua Z. dhe me kapi për krahun e djathtë dhe më ka tërhjekur, ndërsa vajzën të cilën e kisha në ngrykë e kapi e gjuajti në tokë. Z. me një tjetër policë më muren dhe me quan në një dhomë në katin e dytë ku aty ish 5 gra të tjera të zhveshura dhe shumë policë të cilët ti dhunonin ato femra. Aty

[4] ICTR The Prosecutor v. Clément Kayishema and Obed Ruzindana (Trial Judgement) par.75.

2022:279529

Z. me thoshte në gjuhën serbe me i heq teshat.....,.. Aty përfundimisht e mora vesh se që ky personi është Z. sepse shokët e tij vazhdimisht e përmendeshin emrin e tij Z. Z, i cili mi ka zhvesh trenerkat dhe brekët me ka rrezuar për tokë dhe aty me ka dhunuar, kurse shoku i tij mi kapte gjoksat dhe me kafshonte në pjesën e fytyrës dhe në pjesën e epërme të trupit".

Po ashtu në dëshminë e dhënë në shqyrtimin gjyqësor dëshmitarja D.1, ka deklaruar se derisa ishte duke pritur në radhë për tu regjistruar dhe pajisur me kartele aty e mësoj emrin e të akuzuarit prej njerëzve që pritnin aty, të cilët edhe e kishin njohur dhe kishin thënë se është i rrezikshëm, I akuzuari me t'iu afruar D.1, e kishte tërhequr për krahu, vajzën që e mbante në krah i'a kishte përplasur për toke.....i akuzuari e kishte tërhequr D.1 me ndihmën e një polici tjetër dhe e kanë dërguar në katin e dytë, në një dhomë ku kishte edhe femra tjera shqiptare të zhveshura që dhunoheshin nga serbet në mënyrën më brutale.

D.1 gjithashtu dëshmoj se ishte i akuzuari i cili i kishte kërkuar në gjuhën serbe që të zhvishet, por ..... nuk i kishte dëgjuar urdhrat e tij për tu zhveshur dhe... "i akuzuari me forcë i kishte shqyer rrobat në pjesën e sipërme dhe e kishte zhveshur në pjesën e poshtme, duke ia larguar trenerkat dhe brekët dhe e kishte përplasur në dysheme, ku kishte filluar akti i dhunimit, ku shoku i tij i fliste në gjuhën serbe dhe disa herë e kishte thirre në emër "Z., Z." dhe derisa i akuzuari Z., kryente aktin e dhunimit vaginal, polici tjetër ia mbyllte gojën, e puthte në gojë dhe i shtrëngonte gjokset". Duke e përshkruar të akuzuarin Z.V, si një person i gjatë, me flokë ngjyrë kafe, i pashëm, i moshës 25-30 vjeçar, të njëjtin e identifikoj edhe në bazë të fotografisë së asaj kohe, duke theksuar "kurrë prej fytyrës teme nuk hjekësh, kurrë në jetë, edhe pse është e vërtetë se e ka pasur maskën, por me maskë e ka pasur vetëm të mbuluar gojën, por trupi i tij, shikimi i tij, pamja e tij, duart, krejt i mban në mend".

Kolegji vlerëson se nën dritën e kësaj, dëshmia e dëshmitares - dëmtuarës D1 karakterizohet nga qartësia, faktet dhe rrethanat tregohen në përputhje me kronologjinë e zhvillimit dhe logjikën jetësore të ngjarjes, prej fillimit e deri tek trajtimi i saj tek mjekët pas këtyre ndodhive. Është e rëndësishme të potencohet, se dëshmitarja D1 jep fragmente të hollësishme të ngjarjes të cilat mund ti jap vetëm një person që i ka përjetuar dhe parë drejtpërdrejtë, të cilat pastaj i rrëfen në mënyrë të natyrshme.

Aspektet e tilla i japin dëshmisë jo vetëm besueshmëri, por edhe vërtetësi, saktësi dhe objektivitet. Duhet pasur parasysh se dëshmitarja D1 dëshmoi disa herë, dhe ajo ishte në gjendje përkundër ndjeshmërisë, komplikueshmërisë dhe përsëritjes së dëgjimeve të jep deklarata të cilat janë konsistente, pa ndonjë kundërthënie eventuale që do të mund të ngritin ndonjë dyshim në besueshmërinë e vërtetësinë e saj.

2022:279529

Të rëndësishme në këtë kontekst, janë dëshmitë plotësuse në mbështetje të identifikimit të akuzuarit, si deponimet e dëshmitarëve A.V, M.I, Sh.G, V.D tek të cilët ishte kontrolluar pas ngjarjes dhe i'u kishte deklaruar se ishte përdhunuar nga Z.V, si dhe dëshmitari M.Xh.

Rrethanën të cilën e dëshmuan dëshmitarët-mjekët gjatë dëshmisë së tyre konstatohet se e dëmtuara D1, kishte treguar ngjarjen pas dhunimit, përfshirë edhe emrin dhe mbiemrin e personit i cili kishte kryer veprimet inkriminues ndaj saj.

Dëshmitari A.V në dëshminë e tij ka theksuar se kur i kemi hequr rrobat për ta kontrolluar të dëmtuarën D1, kam parë në trupin e saj gërvishje dhe gjakosje, hematoma dhe kafshime ne dhembë në pjesën e gjokseve, ndërsa gërvishje dhe gjakosje dhe hematoma dhe kafshime me dhëmbë në pjesën e gjokseve ishin po ashtu në pjesën e gjokseve në pjesën e stomakut dhe në shpinë. Me të ishte një femër mjeke M.I e cila ishte duke banuar në shtëpinë tij dhe ka punuar me të:

"Unë atëherë kërkova nga ajo që ti kontrolloj gjenitalet e femrës pacientes dhe ajo e përshkroi shumë keq, gjakosje, mavijosje shqyerje me fjalë të tjera ishte në gjendje tronditëse dhe ne i'a dhamë ndihmën e parë. Pasi që kam vërejtur se pacientja ka marr veten dëshmitari V, e ka pyetur me një zë pak më të lartë se kush ta bërë ketë, ajo është përgjigjur Z., pastaj dëshmitari e ka pyetur se cili Z. a e din mbiemrin ajo është përgjigjur Z.V, të cilin unë e njihja".

Dëshmitarja M.I ka dëshmuar se i kujtohet që mbrëmjen e asaj ditë dikush e solli një grua të re e cila ishte në gjendje tejet të rëndë dhe e shqetësuar e cila i ishte e dhunuar, atë femër e pranoj Dr. V dhe kjo ishte e pranishme. Femrën emri i se cilës nuk me kujtohet e kontrolloj fillimisht Dr.V, pastaj me thirri mua dhe me tha që të kontrolloj femrën në pjesën e organeve gjenitale sepse atij i vinte keq që të kontrolloj në atë pjesë të trupit. Femra ishte e zhveshur, në trup ka pasur hematoma dhe gërvishje në pjesën e gjoksit dhe kur e shikova në pjesën e organit gjenital edhe aty kishte shumë hematoma. Duke theksuar se "Unë nuk e kam bërë kontrollën gjinekologjikë sepse nuk jam gjinekologë por siç deklarova konstatova prezencën e hematomave në trupin e saj, në pjesën e gjoksit dhe organit gjenital përreth, për një moment unë dhe Dr,V e kemi pyetur gruan se kush ta beri këtë e ajo u përgjigj "Z.".

Dëshmitarit Sh.G, ndër të tjera kishte deklaruar i kujtohet gjatë bisedës me viktimën D1: "ajo e ka përmendur emrin e kryerësit të dhunimit seksual, ku sipas saj me 22 maj të vitit 1999 është dhunuar nga Z.V nga Vushtrria", në deklaratën e saj ka cekur edhe emrat e disa femrave të tjera, të cilat të njëjtën ditë kanë qenë të dhunuara seksualisht, e njëjta ka qenë shume bindëse se dhunues i saj ka qenë Z. V, dhe ka thëne se është ne gjendje dhe e gatshme të dëshmoj edhe në organet e drejtësisë e të ballafaqohet me të para gjykatës.

2022:279529

Gjithashtu, dëshmitarja V.D ka dëshmuar se pacienten (D1) e ka njohur në tetor të vitit 2017, e cila i ka treguar që është mjeke dhe punon në një organizatë që i trajton dhe i përkrahë të mbijetuarat e dhunës seksuale. Në takim e dytë me të gradualisht duke folur për luftën "e njëjta duke qarë e përshkruan ngjarjen traumatike respektivisht dhunimin i ka thënë se njëri prej tyre ka qenë Z.V".

Kolegji është i bindur se dëshmitë e dëshmitarëve të sipërcekur, janë të besueshme dhe të sakta. Sekuencat e treguara, janë në përputhje me sjelljet që një mjekë do ti kishte në një rast të ngjashëm me një pacientë në rrethana të atilla të asaj kohe. Nuk kanë zbrazëtira e as mospërputhje të brendshme, deklaratat e tyre në vetëvete nuk përmbajnë zbrazëtira ose mangësi të natyrës logjike janë të qarta dhe konsekuente.

Në këtë vijimësi është e rëndësishme edhe dëshmia e dëshmitarit M.Xh, për shkak se bëhet fjalë për një dëshmitar i cili e kishte njohur më parë të akuzuarin, për arsye se ishte banorë i Vushtrrisë, ndërsa i akuzuari kishte punuar në shkrimoren e Gjykatës Komunale në Vushtrri.

Të cilin e përshkruan si një djalë i gjatë, që gjatë kohës së luftës ishte i veshur me rroba të policisë,
e kishte parë të veshur me uniformë policore të akuzuarin Z.V në fillim të muajit maj të viti 1999, herët në mëngjes, rreth orës 07:00 - 07:30, kur i akuzuari së bashku edhe me një policë tjetër i kishin ndaluar me një veturë para dyerve të shtëpisë së axhës së tij Rr.Xh dhe kishin hyrë brenda në shtëpinë e axhës, ku të akuzuarin e kishte njohur pasi ishte pa maskë, me automat në dorë, ndërsa policin tjetër jo, dhe ishte në distancë me ta 22-25 metra, por Z.V të veshur me uniformë policore dhe të armatosur e kishte parë edhe me datën 22 maj të vitit 1999 tek varrezat e qytetit të Vushtrrisë.

Sipas Kolegjit grupi i fakteve të përmendura nga ky dëshmitarë siç janë njohja e mëparshme e të akuzuarit në mënyrë të padyshimtë, e kishte parë pa maskë, të veshur me uniformë policore e të armatosur, e kishte parë tek varrezat e Vushtrrisë. Tregojnë për faktet të cilat përputhen me ecurinë e zhvillimit të ngjarjeve dhe së bashku me dëshminë e të dëmtuarës, dhe dëshmitë e mjekëve japin një panoramë të ngjarjeve ashtu siç përshkruhen në aktakuzë dhe aktgjykimin e atakuar.

Prandaj, Gjykata konstaton se peshimi i faktorëve cilët përdoren në rastin e identifikimit dërgojnë tek një identifikim i vërtetë dhe i saktë, për arsye se mundësia e dëshmitares D1, për të parë të akuzuarin në kohën e kryerjes së veprës penale është evidente dhe padiskutueshme. E pa

2022:279529

në kolonë të njerëzve derisa prisnin për tu regjistruar, i'u kujtua që këtë person e ka parë edhe më herët në fshatin Studime të komunës së Vushtrrisë me dt.2 maj 1999, deri sa shkonin në kolonë dhe në Kooperativën Bujqësore. Pastaj gjatë aktit të përdhunimit kaloi një periudhë të konsiderueshme kohore me sulmuesin e saj - të akuzuarin. Këto rrethana padyshim, tregojnë se dëmtuara objektivisht kishte parë mirë të akuzuarin, më pas në distancë të afërt me të dhe koha e kaluar janë elementë që tregojnë komponentën objektive të dëshmisë. Shkalla e vëmendjes së dëshmitares ishte e lartë, jo vetëm që në atë kohë pa kalonte momente frike e pasigurie, të cilat bëjnë që instiktivisht të rritet vigjilenca njerëzore, por njëjta kishte vërejtur se është duke u shikuar nga i akuzuari, dhe më pas u atakua me dhunë fizike e seksuale. Gjithashtu kishte mësuar identitetin e të akuzuarit.

Në deponimet e saj, prej fillimit ka dhënë përshkrimin të saktë paraprak të tipareve fizike dhe dukjes që i përgjigjen në mënyrë konsekuente të akuzuarit. Gjatë gjithë dëshmive të bëra, dhe gjatë ballafaqimit në shqyrtim gjyqësor demonstroi se është e sigurt në identifikim, nuk shfaqi asnjëherë shenja pasigurie dhe hamendësie.

Sipas Gjykatës, koha e kaluar ndërmjet veprës penale dhe identifikimit, përkundër faktit që arrestimi i të akuzuarit ka ndodhur pas një kohe të gjatë, nuk e vendos në pikëpyetje vërtetësinë e identifikimit, ngase ngjarja e datës 22 maj 1999, ishte dhe mbeti e paharruar dhe e freskët në kujtesën e të dëmtuarës. Është e njohur se viktimat e dhunës seksuale jetojnë në përditshmëri me vështirësitë për ti harruar ndodhitë e tilla, të cilat nuk mund të i'a lënë të kaluarës e harresës. Traumat nuk e bën kujtesën e një personi për këso ngjarje të padenjë, në fakt, ekspertizat tregojnë se përvojat intensive të këtyre ngjarjeve shpesh mbahen mend me saktësi pavarësisht disa mospërputhjeve.[5] Në këtë aspekt faktori kohor ndërlidhet natyrshëm me faktorët e tjerë të lartpërmendur, andaj si e tillë është kompatibil dhe nuk e vënë në diskutueshmëri identifikimin. Ndërsa, lidhur me çështjen e ngritur nga mbrojtësit av. Nebojsa Vlajiq përkitazi me identifikimin e të akuzuarit, përpjekja për të argumentuar se nuk ka kurrfarë rëndësie pasi që nga 10 marsi 2016, kur u arrestua Z.V e deri më sot, shtypi dhe mediat në mënyrë të njëanshme, kanë publikuar fotot e tij, të njëjtat policia dhe prokurori publik më pas i'u treguan dëshmitarëve për qëllime identifikimi.

5. Prosecutor v. Anto Furundzija (Trial Judgement), IT-95-17/1-T, International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia (ICTY), 10 December 1998, par.105.

2022:279529

Gjykata e Apelit vlerëson se ky pretendim mbetet i pa argumentuar, për arsye se nuk ekziston ndonjë provë specifike, e cila do të provonte faktin se pikërisht nën ndikimin e faktorit mediatik e dëmtuara dhe dëshmitarë kanë identifikuar të akuzuarin. Nga faktet e çështjes, konstatohet se e dëmtuara e kishte përmendur të akuzuarin me emër dhe mbiemër, kishte bërë përshkrimin e tij para se mediat të shkruajnë për të akuzuarin.

Mbrojtësi po ashtu konsideron se në këtë çështje kemi të dëmtuarën D 1 e cila thotë se është e dhunuar nga i akuzuari, mirëpo nuk kemi dëshmitarë që e vërteton tregimin e saj.

Sipas Kolegjit janë pretendime të pa bazuara. Nga shpjegimet e dhëna më sipër për dhunimin e të dëmtuarës, përveç dëshmive të elaboruara konfirmon edhe dëshmia e dëshmitares D.B, dhe përshkruante se si D1, me forcë ishte tërhequr, duke ia përplasur vajzën e vogël nga krahu për tokë dhe e kanë tërhequr e kanë dërguar lart në katin e dytë, prej nga edhe i'a kishte dëgjuar piskamën, pastaj dëshmitarët A.V dhe M.I (mjek) të cilët kanë sqaruar se e dëmtuara i'u kishte treguar ngjarjen dhe i'u kishte përmendur emrin e mbiemrin e të akuzuarit në atë kohë.
Për këto arsye, mbi gjendjen e fakteve të konstatuara theksimet e mbrojtjes nuk janë të mjaftueshme për të ngritur dyshime në lidhje me besueshmërinë e dëshmisë së të dëmtuarës D1. Gjykata e shkallës së parë ka trajtuar dhe vlerësuar me kujdes të gjitha deklaratat e sipërcekura, të cilat në ndërlidhje edhe me faktet dhe provat e tjera si dhe nga tërësia e tyre është nxjerrë konkludimi që dëshmojnë për veprimet e të akuzuarit në kryerjen e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor.

Po ashtu, sipas mbrojtësit nuk mund të argumentohet edhe rrethana se si pasojë e dhunimit e dëmtuara D 1 katër muaj pas ngjarjes, ka pësuar abort dhe ka humbur binjakët.

Kolegji vëren se në rastin konkret duke marrë parasysh rrethanat e luftës, fakti se me datën 22 maj të vitit 1999 e dëmtuara D.1 u dhunua nga i akuzuari dhe pësoi lëndimet në trupin e saj, në atë kohë ishte shtatzënë, ndërsa me datë 22 shtator të atij viti 1999 ka pësuar abort dhe ka humbur fëmijët e saj binjakë. Megjithatë, çështja e abortit dhe ngritja e lidhjes kauzale me dhunimin nuk është një çështje substanciale në raport me ekzistimin apo jo të veprës penale, për rrjedhojë edhe të përgjegjësisë penale për të akuzuarin, por vendimtare është fakti i dhunimit seksual të dëmtuarës dhe aspekti i të provuarit të këtyre veprimeve inkriminuese.

2022:279529

Ndërsa lidhur me natyrën e kontrolleve mjekësore, lëndimeve e pësuara dhe dhunës seksuale gjykata e shkallës së parë mbi këtë rrethanë ka dhënë arsye, se mjekët e lartcekur, ishin specialist të mjekësisë familjare, nuk ishin gjinekolog dhe se të dëmtuarës nuk i bënë kontrolle gjinekologjike, ngase nuk ishin të thirrur për atë specializim, nuk kishin as pajisje, por të njëjtit me përshkrimin e gjendjes së të dëmtuarës, lëndimeve në trupin e saj ku kishte hematome, kafshime, gërvishtje, në pjesën e sipërme–gjoks, qafë, shqyerje dhe gjakderdhje tek organet gjenitale, ka qenë e mjaftueshme për tu konstatuar se e njëjta ishte dhunuar, po ashtu duke marrë për bazë gjendjen e luftës, në ato rrethana është pamundësuar kontrolla gjinekologjike me ekspertiza më të thelluara mjekësore.

Përveç të dëmtuarës, të akuzuarin e kanë njohur edhe dëshmitarët dhe nuk ishte problem për ta, pasi e kishin njohur shumë mirë edhe më parë siç kanë deklaruar në deklarimet e tyre, prandaj përpjekja për këtë argumentim mbetet në nivel të supozimit abstrakt, e pambështetur me ndonjë fakt a rrethanë më konkrete që do ta bënte eventualisht të besueshëm.

Ndërkaq pretendimet e mbrojtësit lidhur me fshehjen e identitetit të viktimës dëshmitarët e dëgjuar në dëshmitë e tyre kanë përdorur shprehjet "paciente, një grua, ajo grua, ajo", doktoresha M., as nuk e njihte, as nuk e pyeti për emrin, nuk e dimë për kë e kanë fjalën. E njëjta gjë vlen edhe për doktorin V., i cili gjithashtu nuk e tha emrin e asaj pacienteje, të dëmtuarës, as nuk e tha asnjëherë pseudonimin e saj D 1. Pra, tani nuk e dimë se për cilin person kanë dëshmuar, për të dëmtuarin D 1, ndoshta për motrën e saj S. (të cilën gjithashtu e kanë kontrolluar) ose rreth një personi të tretë femër.

Në vlerësimin e Gjykatës janë të paqëndrueshme dhe pajtohet me pikëpamjen e gjykatës së shkallës së parë, ngase nga fillimi i procedurës si në polici, prokurori të gjithë dëshmitarët kanë qenë në dijeni se për cilën grua po dëshmonin, po ashtu kanë qenë në dijeni për emrin e të dëmtuarës, edhe vet i akuzuari dhe mbrojtësi ishin në dijeni për emrin e gruas, mirëpo për shkak të ruajtjes se konfidencialitetit, të gjitha dëshmitarët janë udhëzuar dhe paralajmëruar nga gjykata për detyrimet e tyre, lidhur me anonimitetin e dëshmitares e cila kishte pseudonimin D.1 dhe të kenë kujdes në zbulimin e emrit të saj, dhe këtë udhëzim gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka dëgjuar edhe mbrojtësi.

Kolegji çmon se nga përmbajtja e dëshmive dhe rrethanat për cila dëshmuan dëshmitarët, nuk ekzistonte asnjë dyshim gjatë procesit gjyqësor se ishte fjala për të dëmtuarën D1 dhe asaj i

2022:279529

dedikohet, insistimi tani në krijimin e dyshimit dhe për të vënë pyetje se ishte fjala për të dëmtuarën apo jo, duket artificiale e qartazi i paarsyeshëm.

I akuzuari dhe mbrojtësi ngritën çështjen se zhvillimi i më shumë procedurave për krimeve luftës kundër të pandehurit V., është i palejueshëm. Duke shtuar se ndaj të njëjtit janë duke u zhvilluar të paktën katër procedura për krime lufte, ndërsa në vazhdimësi kanë propozuar që procedurat të bashkohen, për faktin katër procedurat janë të lidhura në kohë ashtu edhe në natyrën e tyre, do të ishte e duhur zhvillimi i një procedure të vetme kundër tij dhe ti shqiptohet një dënim unik. Sipas Kolegjit, në situatat kur zbulohet dhe procedohet një rast i ri për krime lufte, kjo nuk nënkupton se duhet automatikisht t'iu bashkohet rasteve të tjera të cilat një herë janë gjykuar dhe janë në fazën e rigjykimit. Duke pasur parasysh se në rastin konkret, kemi të bëjmë me rastet e krimeve të luftës kundër të akuzuarit, të cilat nuk janë identike me rastin e dhunimit pasi që kanë palë tjera të dëmtuara, kurse në këtë çështje penale ka qenë një e dëmtuar dëshmitare me urdhër për masë mbrojtëse, në mënyrë që mos të zbulohet identiteti i të dhënave të saj për shkaqe morale. Andaj, ka qenë e domosdoshme të zhvillohet një procedurë e ndarë me qëllim të mbrojtjes së identitetit të viktimës së dhunimit, për kundër faktit se jo të gjitha procedurat ndaj të akuzuarit ishin në stadin e njëjtë të procedimit dhe ndaj të njëjtit ka raste të cilat janë kthyer në rigjykim.

6.3.<u>Të gjeturat për pretendimet ankimore në ankesën e të akuzuarit Z.V</u>

Kolegji pretendimet e theksuara në ankesën e të akuzuarit i vlerësoi si të paargumentuara, jo bindëse dhe në disa segmente të përgjithësuara se në deklaratat e dëmtuarës D1 dhe të dëshmitarëve rezultojnë paqartësi dhe kundërthënie përmbajtjesore. Pretendimet e të akuzuarit se D1, ka deklaruar se ka pasur flokët të zeza dhe pastaj të kafta, se ka pasur maskë vetëm në gojë.

Sipas Kolegjit janë pretendime të paqëndrueshme, ngjyra e zezë dhe e kaftë janë në afërsi të konsiderueshme, nuk bëhet fjalë për një dallim esencial të ngjyrave që do të ishte qartazi një kontrast si psh: të përshkruaj me flokë verdha. Nga të mbijetuarit e këtyre përvojave nuk mund të pritet në mënyrë të arsyeshme me rastin e riprodhimit të kujtesës të kenë një saktësi kompjuterike. Për më tepër, mospërputhjet në këto rrethana mund të tregojnë vërtetësinë dhe

2022:279529

mungesën e ndërhyrjes (ndikimit) në dëshmitaren.[6] Ndërsa në relacion me çështjen e maskës, dëshminë e të dëmtuarës e karakterizon bindshmëria dhe preciziteti në raport me pozicionin e maskës e cila ka mbuluar pjesën e gojës, por nga e cila nuk ka qenë e mbuluar fytyra si tërësi si dhe sytë e flokët. Madje lidhur me këtë rrethanë, e dëmtuara në dëshmitë e saj si një prej veçorive e përshkruan të akuzuarin si "një person i pashëm", nga rrjedh edhe konluzioni logjik se e dëmtuara kishte mundësinë që të shohë mjaftueshëm edhe fytyrën e tij, andaj si rezultat i këtij perceptimi pamor duke përfshirë edhe këtë rrethanë është dhënë edhe dëshmia e saj.

Rrethana se a kanë pasur ordinanca mjekësore mjekët, dhe se në çfarë gjendje ka qenë e dëmtuara janë qartësuar mjaftueshëm nga shpjegimet e dëshmitarëve, Kolegji nuk vëren ndonjë kontradiktë të natyrës përmbajtjesore të rëndësishme. Vërejtjet lidhur me divergjencat në deklarimet e mjekëve dhe rrethana se nuk kanë mbajtur evidenca të pacientëve, deklarimet e tyre për emrin e Z.V. Sipas Kolegjit aspekti se pse nuk kanë mbajtur evidenca administrative nën optikën e rrethanave të luftës në atë kohë është e justifikueshme, në atë gjendje e rëndësishme ka qenë ofrimi i ndihmës mjekësore të njerëzve për nevoja shëndetësore dhe jo edhe përmbushja e aspekteve administrative të evidentimit të pacientëve.

Ndërsa lidhur me çështjen e emrit të akuzuarit, Kolegji vëren, nuk ka ndonjë mospërputhje thelbësore përveç aspekteve jo përmbajtjesore në raport me renditjen e fjalëve, të cilat janë të natyrshme në rastet kur një dëshmitar merret në pyetje disa herë, mospërputhje të tilla jo substanciale nuk e vënë në pyetje kredibilitetin e këtyre dëshmive. Kolegji rikujton se në procedurën penale dy dëshmi të besueshme prima facie, nuk duhet nënkuptuar se duhet jenë tërësisht identike në të gjitha aspektet ose të përshkruajnë të njëjtin fakt në mënyrë absolute në të njëjtën mënyrë që të konsiderohen si vërtetuese. Çdo dëshmitar, paraqet atë që ka parë nga këndvështrimi i tij në kohën e ngjarjeve, ose sipas mënyrës se si i ka kuptuar ngjarjet e rrëfyera nga të tjerët.[7] Prandaj mospërputhjet eventuale, minore e të parëndësishme nuk janë të mjaftueshme për të hedhur dyshime mbi dëshmitë e këtyre dëshmitarëve.

Kolegji trajtoi edhe pretendimet për hapësirën e dhomës dhe një vet llogaritje nga i akuzuari se nuk mund të vendoset ai numër i njerëzve, dhe erdhi në përfundim se është e karakterit e

[6] Prosecutor v. Anto Furundzija (Trial Judgement), IT-95-17/1-T, International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia (ICTY), 10 December 1998, par.113.

[7] Dominique Ntawukulilyayo v. The Prosecutor, Case No. ICTR-05-82-A, Judgement, 14 December 2011 ("Ntawukulilyayo Appeal Judgement par.24").

2022:279529

hipotetik, e pa mbështetur me ndonjë të dhënë specifike e konkrete, si e tillë nuk e vë në pyetje saktësinë e dëshmisë së të dëmtuarës.

Për rrjedhojë, Gjykata e Apelit e Kosovës nga arsyet e shpjeguara më sipër arriti në përfundimin se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike në këtë çështje penale, dhe se deklarimet e ngritura të natyrës faktike nga mbrojtësi dhe i akuzuari në ankesë nuk e vënë në dyshim gjendjen e fakteve të konstatuara nga gjykata sipas aktgjykimit që është objekt shqyrtimi.

6.4. Të gjeturat lidhur me shkeljen e ligj penal

Pretendimet e Prokurorit se gjykata me rastin e cilësimit juridik të veprës penale është dashur të aprovoj cilësimin juridik nga aktakuza për veprën penale Krimet e luftës kundër popullsisë civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë e kryer në bashkëkryerje me pjesëtarët e tjerë të panjohur të njësitit të përmendur rezervist të policisë serbe dhe personat e tjerë të armatosur dhe të unformuar, aktualisht e inkriminuar si Krimet kundër njerëzimit nga neni 143 par. l nënpar.1.4, 1.6 dhe 1.7 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ashtu që vepra penale të cilësohet jo vetëm sipas ligjit nga koha në të cilën vepra penale është kryer por edhe nga aspekti i ligjit që është aktualisht në fuqi.

Kolegji vlerëson se janë pretendime të pa bazuara, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ndaj të akuzuarit ka aplikuar ligjin penal i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, i cili ligj është me i favorshëm për të akuzuarin, pavarësisht faktit se kjo vepër penale është e ndëshkueshme edhe me kodin penal aktual në fuqi, për më tepër prokuroria nuk ka ofruar ndonjë arsye apo argument për ta bërë bindës këtë qëndrim, përveç theksimit se duhet shikuar mundësinë e zbatimit të kodit penal aktual e jo çdoherë të ligji penal që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, kjo nuk paraqet ndonjë argumentim të kësaj kërkese.

Prandaj Kolegji gjen se pretendimet e prokurorit dhe të mbrojtësit për shkeljen të ligjit penal janë të paqëndrueshme, me aktgjykimin e ankimuar nuk është shkelur ligji penal siç pretendon prokurori dhe mbrojtësit i të akuzuarit, për faktin se në gjendjen faktike të provuar në veprimet e të akuzuarit formësohen tiparet objektive dhe subjektive për veprën penale Krimet e luftës kundër popullsisë civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë e kryer në bashkëkryerje me pjesëtarët e tjerë të panjohur të njësitit të

2022:279529

përmendur rezervist të policisë serbe dhe personat e tjerë të armatosur, për të cilën është penalisht përgjegjës dhe i fajshëm si dhe nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të akuzuarit.

6.5.Të gjeturat për vendimin mbi dënimin

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e prokurorisë për një dënim me të ashpër janë të bazuara, ndërsa pretendimet e mbrojtësit dhe të akuzuarit siç dihet kanë qenë për lirim nga akuza.

Gjatë matjes se dënimit për të akuzuarin, gjykata e shkallës së parë, mori në konsideratë dhe vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të dispozitave të nenit 41 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, të cilat rrethana ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit duke mos gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese për të akuzuarin, si rrethana rëndësuese ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe ka gjetur se i akuzuari ishte nëpunës i gjykatës në Vushtrri, ndërsa gjatë periudhës së konfliktit të armatosur ishte rezervist i policisë Serbe dhe me dashje dhe vetëdije të plotë e ka kryer veprën penale në bashkëkryerje edhe me pjesëtar tjerë të forcave serbe.

Gjykata e shkallë së parë, po ashtu ka vlerësuar motivin e kryerjes së veprës penale dhe cenimin e viktimës, ku u është vërtetuar se i akuzuari veprën penale e ka kryer ndaj gruas – viktimës së nacionalitetit shqiptar, kurse në rrethanat në të cilat është kryer vepra penale kjo ishte e lidhur qartë me situatën e krijuar nga konflikti i armatosur që ishte duke u zhvilluar, po ashtu sjellja e të akuzuarit para dhe pas kryerjes së veprës penale, këtë e kanë vërtetuar e dëmtuara D.1 dhe dëshmitarët se i akuzuari kishte sjellje brutale ndaj popullatës civile shqiptare duke i sulmuar fizikisht me shkop druri dhe sjelljet e tij janë vërtetuar edhe me aktgjykimin e plotfuqishëm të gjykatës Themelore në Mitrovicë, ku i akuzuari për shkak të trajtimit çnjerëzor dhe vuajtjeve të shkaktuara përmes shkaktimit të rrahjeve, shkeljeve të integritetit trupor dhe shëndetit edhe ka vuajtur dënimin dhe mbështetur mbi këto arsye.

Duke i marr për bazë rrethanat e lartcekura të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin brenda kufijve të paraparë ligjor për këtë vepër penale, me bindje se me këtë dënim do të arrihet efekti preventiv i dënimit, respektivisht që në të ardhmen të përmbahen nga këto veprime / kryerja e veprave penale.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit pjesërisht si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo Gjykatë.

2022:279529

Kolegji nuk ndan pikëpamjen e njëjtë me gjykatën e shkallës së parë të shprehur në aktgjykimin e ankimuar për disa rrethana, siç janë se veprën penale e ka kryer me vetëdije të plotë, kur një fakt i tillë është prezumim dhe vetëm në raste të dyshimit për gjendjen e vetëdijes atëherë mund të diskutohet, në këtë kontekst marrë parasysh edhe natyrën e veprës për të cilën është shpallur fajtor dhe rrethanat e kryerjes së veprës, kategoria e tillë e veprave penale zakonisht kryhen me vetëdije të plotë dhe nuk ka qenë kontestuese. Ndërsa rrethana se vepra është kryer në kuadër të ekzistimit të konfliktit të armatosur, nuk mund të konsiderohet si rënduese, meqenëse paraqet tipar të veprës penale për të cilën është shpall fajtor dhe dënuar i akuzuari.

Kolegji vëren se rrethanat në të cilat ka ndodhur vepra penale nuk janë adresuar e peshuar në masë të mjaftueshme, në kuptim të dispozitës së lartcituar, të cilat do të ndikonin në shqiptimin e dënimit më të rëndë dhe me këtë pajtohet me pikëpamjen e prokurorit. Nuk është çmuar rrethana se dhunimi është kryer në mënyrë poshtëruese e brutale në ditën kritike, përderisa viktima ishte ndarë më forcë nga fëmija i saj të cilën e mbante në krah, duke i'a kapur dhe gjuajtur në tokë, duke mos pasur në konsideratë dhe ndjenja humane as për fëmiun, pastaj duke e tërhjekur me forcë e larguan në një dhomë ku ishin prezentë disa gra të tjera të dhunuara nga policë të tjerë. E dëmtuara u dhunua nga i akuzuari dhe një policë tjetër i paidentifikuar i cili abuzonte me trupin e saj, në mënyrën siç përshkruhet në dispozitiv të aktgjykimit, veprime të tilla dëshmojnë se dhunimi ishte kryer jo vetëm në mënyrë të egër, të vrazhdë por edhe poshtëruese. Në këtë mënyrë duke cenuar rëndë dinjitetin e viktimës, prandaj faktorët e tillë duhet të merren parasysh dhe të kenë ndikimin e duhur në masën e dënimit të përcaktuar.

Rrjedhimisht, kjo Gjykatë vlerëson se këto rrethana në unitetin e tyre japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit me burgim në kohëzgjatje prej 13 (trembëdhjetë) vite, me bindjen se dënimi tani i shqiptuar është në proporcion dhe plotësisht i justifikueshëm në raport me peshën konkrete të veprës penale, rrethanave të kryerjes, shkallën e lartë të përgjegjësisë penale të akuzuarit, tek i cili është manifestuar kuantum i avancuar i vullnetit kriminal, tërësisë së sjelljes së tij kriminale dhe me të njëkohësisht arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale dhe asaj gjenerale.

2022:279529

Kolegji dëshiron të qartësoj faktin se Gjykata e Apelit me aktvendimin e evidentuar si APS.nr.35/2021[8], të datës 21 dhjetor 2021 Gjykata e Apelit të Kosovës, kishte aprovuar e ankesën e të akuzuarit Z.V dhe mbrojtësit të tij avokat Nebojsha Vlajiq, duke anuluar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special PS.nr.15/2020, të datës 05 korrik 2021, dhe çështja është kthyer në rigjykim.

Sipas interpretimit të Kolegjit nuk mundë të nënkuptoj se tani kemi të bëjmë me një situatë kur jemi të limituar me ndalesën reformatio in peius të përcaktuar nga dispozita e nenit 385 të KPPK-së, pasi anulimi ishte bërë për shkak të gjeturave për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas pretendimeve të ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit, dhe se pretendimet ankimore të prokurorit ishin konsideruar si jo lëndore, për rrjedhojë nuk ishin trajtuar në aktvendimin e mëparshëm.

7. Përfundimi

Kolegji Gjykatës së Apelit arriti në përfundim se nuk ekzistojnë shkelje të dispozitave të procedurës penale, përfshirë edhe shkeljet që Gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe as aplikim të gabuar të ligjit penal të pretenduara në ankesat e mbrojtësit dhe të akuzuarit , dhe as të prokurorit lidhur me shkeljen e ligjit penal, ndërsa të bazuar e gjeti pjesërisht ankesën e prokurorit lidhur me vendimin mbi dënimin, të cilën e aprovoi si të bazuar, duke i shqiptuar dënim me burgimi në kohëzgjatjen e përcaktuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e sipër cekura dhe në bazë të nenit 403 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
DEPARTAMENTI SPECIAL
APS.nr. 50/2022
Datë: 15.02.2023

[8] Aktvendimi i gjykatës së Apelit APS.nr.35/2021, i datës 21 dhjetor 2021, (data e smilit 21 korrik 2022).

2022:279529

Bashkëpunëtorja Profesionale,	Anëtarët e kolegjit,	Kryetare e kolegjit,
Syzana Goxhuli	Bashkim Hyseni	Afërdita Bytyçi
	Ferit Osmani	